




REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Glogocit (Drenasit)
Kuvendi Komunal



**UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS NË LIDHJE ME MËSIMIN NË DISTANCË PËR
NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA**



**UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS NË LIDHJE ME MËSIMIN NË DISTANCË PËR
NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA**

Nën kujdesin e: MA. ARIANA ISUFI

Përgaditur nga:

KOMITETI KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Korrik, 2020

*Përmbajtja e këtij udhëzuesi është përgjegjësi e KKPAK.

Ky udhëzues është hartuar me kontributin anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Drenas, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, në ndihmë të mësimeve, por edhe nxënësve me nevoja të veçanta dhe prindërve, si palë të involvuara në institucionet edukativo-arsimore. Motivi për hartimin e këtij udhëzuesi, rrjedhë nga rezultatet e nxjerra nga hulumtimi i realizuar nga ky komitet në Qërshor 2020, në lidhje me “Identifikimin e sfidave të mësimit dhe mësimit për nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e komunës së Drenasit, gjatë periudhës së pandemisë Covid-19”, nga ku kemi parë nevojën për burime të reja siç është ky udhëzues në mënyrë që të ndihmojë mësuesin në mësimin me nxënësit me nevoja të veçanta, për aq kohë sa do të vazhdojë mësimi në distancë. Ky udhëzues mund të shërbejë në çdo lloj situatë, e cila obligon mbajtjen e mësimit në distancë.

Drejtuese e grupit të punës: MA. Ariana Isufi

Grupi punues: Ariana Isufi (psikologe)

Arlindë Krasniqi (psikologe)

Burim Fazliu (doktor)

Jehona Avdyli (pedagoge)

Shemsi Bërbatovci (mësues)

*** Me përkrahjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Drenas**

PËRMBAJTJA

I QËLLIMI DHE RËNDËSIA E UDHËZUESIT.....	7
II PËRKUFIZIME.....	7
III HYRJE.....	9
BALLAFAQIMI DHE TEJKALIMI I SFIDAVE NË MËSIMDHËNIE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA.....	11
TEJKALIMI I SFIDAVE NË MËSIMNXËNIE GJATË MËSIMIT NË DISTANCE PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA.....	12
BASHKËPUNIMI MËSIMDHËNËS – PRIND.....	14
BASHKËPUNIMI MËSIMDHËNËS – PSIKOLOG GJATË MËSIMIT NË DISTANCË NË LIDHJE ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA.....	16
BASHKËPUNIMI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ME BASHKËMOSHATARËT E TYRE - INKURAJIMI NGA MËSIMDHËNËSIT.....	18
KOMUNIKIMI I MËSIMDHËNËSVE ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA GJATË MËSIMIT NË DISTANCË.....	20
LITERATURA.....	22

SHKURTESAT

DKA Drejtoria Komunale e Arsimit

IDEA Ligji i Individëve me Aftësi të Kufizuara të Amerikës

KKPAK Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PIA Plani Individual i Arsimit

TIK Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit

“Nëse ju e gjykoni një peshk nga aftësia e tij për t’u ngjitur në një pemë, ai do të jetoj gjithë jetën duke besuar se është budalla” – Ajnshtajn

I. QËLLIMI DHE RËNDËSIA E UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ndihmojë mësimdhënësit në tejkalimin e sfidave si dhe përgaditjen më të mirë për të punuar në mjedise online, me nxënësit me nevoja të veçanta. Me zbatimin efikas të këtyre parimeve mësimdhënësit mund ta rrisin performancën e tyre të mësimdhënies dhe ndihmojnë nxënësit në mësimnxënie, pavarësisht pengesave të përditshme që hasen mësimdhënësit apo edhe nxënësit si rezultat i aftësisë së tyre të kufizuar apo çfarëdo vështirësie tjetër.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e situatës që po kalojmë, të papriturat që ka sjellur mësimi në distancë dhe faktin që çdo shkollë dhe nxënës ka specifikat dhe nevojat e veta, e rëndësishme është që udhëzuesi jep disa parime dhe ide se si shkollat dhe mësimdhënësit mund të punojnë me nxënësit me nevoja të veçanta duke iu përshtatur rrethanave, mundësive dhe specifikave të tyre. Përshtatja nënkupton ndryshimin e kushteve të të nxënës për të plotësuar nevojat e nxënësve, më tepër se sa përpjekjet e nxënësve për t’iu përshtatur nevojave të sistemit.

II. PËRKUFIZIME

Definimi **“Persona me Nevoja të veçanta”** nënkupton individët me dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.¹

Mësimdhënia në funksion të rritjes së kompetencave kërkon organizimin e mësimdhënies dhe nxënies me metoda dhe teknika të cilat integrojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Ajo ka për bazë rezultatet e të nxënës të kompetencave, të cilat e orientojnë mësimdhënësin se çfarë duhet të dijë, të bëjë, të kuptojë, të vlerësojë dhe si të marrë qëndrime nxënësi në situata dhe për situata të caktuara.

Mësimnxënia, procesi i fitimit, absorbimit dhe zhvillimit të dijeve, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të reja, që janë të integruar në strukturat para-ekzistuese, ndërsa gjithashtu përbëjnë një bazë për përvetësime të reja.²

Gjithëpërfshirja, nënkupton ofrimin e mundësisë për përfshirje dhe qasje të barabartë të të gjithë e fëmijëve dhe të rinjve në arsim cilësor.

¹ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2006, faqe 5

² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>

Gjithpërfshirja është një term i lidhur ngushtë me diversitetin. Merr në konsideratë ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet fëmijëve: moshën, gjininë, pasurinë, nevojat e veçanta, kulturën, fenë, vendbanimin, statusin shëndetësor, social dhe etik.

Gjithpërfshirje do të thotë njohje dhe pranim i ndryshimeve mes fëmijëve dhe përdorim pozitiv i këtij fakti për të siguruar një zhvillim dhe edukim cilësor për të gjithë ata.

Realizimi i procesit të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim bën të mundur: Krijimin e një “kulture” që nënkupton vlerësimin, pranimin dhe mbështetjen e diversitetit të fëmijëve.³

Mësimi në distancë/online në një term më të gjerë tregon distancën e prekshme midis nxënësit dhe mësimit ku mësimi nuk kufizohet më brenda katër mureve të klasës. Programet e mësimit në distancë ua mundësojnë të interesuarve dhe mësuesve të ndërveprojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet mjeteve kompjuterike, internetit, satelitëve artificialë, telefonave, radiove, televizioneve dhe teknologjive të tjera.⁴

³ https://www.wvi.org/sites/default/files/Raport_Rajonal_2_Alb_Web.pdf

⁴ Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2011, faqe 9

III. HYRJJE

Përhapja e pandemisë Covid-19 ka shkaktuar sfidë në të gjithë botën, duke lënë pasojat e tij në jetën personale dhe sociale për të gjithë ne, përfshirë edhe arsimin. Kalimi i shpejtë i mësimin në formën online, ka ndikuar që mësuesit, prindërit dhe nxënësit të përjetojnë një numër të madh ndryshimesh të rëndësishme në një periudhë të shkurtër kohore.

Organizimi i mësimin në distancë/ formën online është bërë rrugë e shpëtimit për arsimin si një strategji alternative në mënyrë që të sigurohet vazhdimi i procesit mësimor dhe angazhimi i nxënësve, kjo ngase pandemia ka ndikim të kushtëzuar në mënyrën sesi tashtme duhet të ndërtojmë punën tonë në këto kontekste të reja, si rezultat i ndërprerjes së mësimin në ambientet edukative. Andaj, përshtatja me situata të reja është një avantazh për të tejkaluar më lehtë këto sfida. Siç e dijme, një mësimdhënie e tillë nuk ka teknika dhe metoda të gatshme për punën me nxënës me nevoja të veçanta, por do të jeni më afër suksesit, atëherë kur secili mësimdhënës të zgjedhë platformat dhe burimet e mësimin të disponueshme për të gjitha nevojat e nxënësve.

Personat me nevoja të veçanta, edhe në rrethana normale ka më shumë të ngjarë të jetojnë në varfëri, të përjetojnë nivele më të larta dhune, neglizhencë dhe abuzim, dhe janë ndër më të marginalizuarit në çdo komunitet të prekur nga krizat, kurse Covid-19 e ka shtuar më tej këtë situatë. Andaj, kërkohet një qasje e integruar dhe kombinim i masave për të siguruar që nxënësit me nevoja të veçanta të vendosen në qendër. Poashtu, në krizat shëndetësore siç është Covid-19, fëmijëve me nevoja të veçanta shpesh u sigurohet më pak ndihmë dhe mësues të trajnuar në mënyrë jo adekuate, andaj në punën me këta fëmijë kërkohet më shumë kohë dhe burime në mënyrë që të marrin pjesë aktive në mësim. Kjo përfshin pajisje, qasje në internet, materiale dhe mbështetje të dizajnuara posaçërisht për ta, pasi që kjo e bën mësimin më të kushtueshëm për nxënësit dhe familjet e tyre. Gjithashtu, në lidhje me ofrimin e mësimin në distancë/ online, aktualisht, nuk ka të dhëna të disponueshme për aftësitë dixhitale të mësuesve të arsimit special në vendet në zhvillim ose më pak të zhvilluara, por edhe në komunën e Drenasit, mund të konsiderohet si një pengesë tjetër që shumë mësuesve u mungojnë aftësitë dhe njohuritë e TIK-ut. Si rezultat, ata nuk janë të përgatitur sa duhet të japin mësim në internet dhe nuk mund të sigurojnë angazhimin e synuar të nxënësve, veçanërisht për nxënësit me nevoja të veçanta, por, vështirësitë shihen edhe anasjelltas, sepse edhe nxënësit kanë vështirësi në përdorimin e TIK-ut. Andaj, duhen perspektiva të reja në mënyrë që të kontribuohet drejtë krijimtarisë, qasjeve të reja dhe zgjidhjeve inovative për sfidat (Hyseni-Duraku & Hoxha, 2020).

Si rezultat, pas identifikimit të një varg sfidash me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit dhe nxënësit, kemi ardhur në përfundim se faktikisht mësimi në distancë/online në komunën e Drenasit në kushtet e pandemisë, sikur edhe në shumicën e vendeve të rajonit, ka filluar pa përgaditjet e duhura që do të duhej ta shoqëronin mësimdhënien dhe mësimnxënien. Prandaj, edhe duhet pranuar se mësimi në distancë ballafaqohet me të panjohura, të cilat duhet të adresohen me kohë dhe duke ju përshtatur kontekstit. Bazuar në gjithë këtë që u tha, qëllimi i përgjithshëm i këtij udhëzuesi është që të ua lehtësoj mësimdhënësve dhe nxënësve me nevoja të veçanta t'i tejkalojnë

sfidat që ballafaqohen përgjatë mësimin në distancë si shkak i pandemisë apo çfarëdo lloj situatë që pamundëson mësimin në institucionet edukative, sepse, në fakt, mungesa e udhëzimeve për të ndihmuar shkollat në krijimin e një sistemi virtual të arsimit me udhëzime të qarta dhe pa kompromis për cilësinë e arsimit, ka çuar në sfida të rënda.

Përvoja e hulumtimeve ka vërtetuar se arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta mund të bëhet më efektiv, atëherë kur:

- Të jenë të gatshëm të çojnë një jetë të pavarur e produktive, në maksimumin e mundshëm;
- Të arrijnë qëllimet zhvillimore, dhe aq sa është e mundur, të realizojnë pritshmërinë sfiduese që janë caktuar për të gjithë fëmijët;
- Fuqizohet roli dhe përgjegjësia e prindërve dhe duke u siguruar që familjet e fëmijëve të tillë të kenë mundësi të mira të marrin pjesë në arsimimin e fëmijëve të tyre në shkollë dhe në shtëpi;
- Ofruar arsim special të duhur dhe shërbime të këtij lloji, si dhe ndihmë dhe përkrahje për këta fëmijë që janë në klasat e rregullta, kurdo që paraqitet nevoja;
- Përkrahur zhvillimin dhe shfrytëzimin e teknologjisë, përfshirë këtu mjetet dhe shërbimet e teknologjisë ndihmëse (asistive), për të mundësuar plotësimin e kërkesave për fëmijët me nevoja të veçanta, etj.⁵

- **Bazuar në nevojat e mësimdhënësve dhe nxënësve për t'i tejkaluar këto sfida, më poshtë do të jenë disa parime themelore, të bazuara në kërkime dhe shkencë, të cilat ofrojnë një strukturë gjithëpërfshirëse të qasjes tuaj dhe e bëjnë mësimin më produktiv dhe të qëndrueshëm për nxënësit me nevoja të veçanta - pavarësisht nga materialet mësimore në shkollë.**

⁵ Ligji i Individëve me Aftësi të Kufizuara të Amerikës, 2005, faqe 13-14.

1. BALLAFAQIMI DHE TEJKALIMI I SFIDAVE NË MËSIMDHËNIE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË/ONLINE MË NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Mësimdhënësit sigurisht e shohin si nevojë që angazhimin e tyre ta orientojnë në adaptimin e strategjive të arsimit, si dhe organizimin e mëtutjeshëm të mësimit online në mënyrë që mësimi i realizuar të ketë efekte pozitive dhe afatgjata në të gjitha palët e involvuara dhe përfituese të institucioneve edukativo-arsimore. Por, mos të harrojmë një fakt se ne mund të planifikojmë kurrikula për mësimin online, të krijojmë mënyra të reja për prezantimin e përmbajtjes dhe të përtërijmë protokollet tona të vlerësimit për mësimin në këtë formë, por me kaq shumë të panjohura në këtë kohë, mirëqenia emocionale dhe sociale e nxënësve duhet të jenë përparësi. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve, ballafaqimi me këtë formë të mësimit shpesh herë paraqet vështirësi të niveleve të ndryshme. Mësimdhënësit, kohë pas kohe mund të kenë probleme me internetin, apo me aplikacionet e rrjeteve sociale që ofrojnë telefonat e mençur si (*Viber, WhatsApp, facebook etj*), ku shumë nga këto aplikacione nuk janë kanale të komunikimit të sanksionuara zyrtarisht nga shkollat, apo shumë nga mësimdhënësit mund të kenë mungesë të njohurive në përdorimin e këtyre aplikacioneve.

Në kushtet e zhvillimit të mësimit online apo në distancë, mësimdhënia për nxënësit me nevoja të veçanta do të duhej të mbështetej në këto parime për t'i tejkaluar më lehtë sfidat:

Parimi 1. Planifikoni kohën e domosdoshme për përgaditjen e mësimit online me nxënësit me nevoja të veçanta.

Nëse mësimdhënësit shohin sfidë kohën e kufizuar që u duhet për të përgatitur përmbajtje të cilat mbështesin nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta, si rezultat i numrit të madh të nxënësve apo pasi që kombinimi i aksesit joadekuat në mjetet e teknologjisë dhe politikave kufizuese të arsimit i përkeqëson këto kufizime kohore, atëherë mësimdhënësit rekomandohet që të përgadisnin një orar për veten, duke specifikuar kohën për: përgaditjen e mësimit, gjetjen e një hapësire që minimizon mundësitë për shpërqendrim, kohën për ushqim, gjumë, dhe aspekte të tjera të kujdesit për veten.

Parimi 2. Gjeni bashkëpunimin e duhur në lidhje me përdorimin e teknologjisë (aftësitë digjitale, aplikacionet e përshtatshme, etj).

Në rast se keni vështirësi apo pasiguri në përdorimin e teknologjisë për të realizuar mësimin online, kërkonin ndihmë tek një kolegë apo i afërm i juaj i cili mund të ju ndihmojë, si dhe përpunoni t'i përshtasni metodat sipas nivelit tuaj dhe të nxënësve me nevoja të veçanta për shfrytëzimin e teknologjisë, në mënyrë që të siguronin angazhimin e nxënësve.

Parimi 3. Vlerësoni përpjekjet e nxënësve me nevoja të veçanta, dhe inkurajoni specifikisht arritjet e tyre sipas nivelit të arsimit dhe tipit të dëmtimit.

Për fëmijët me nevoja të veçanta, vetë-vetëdija (njohuri për pikat e forta, të dobëta, dhe talentet e veçanta) dhe vetëbesimi janë shumë të rëndësishme. Dështimi mund të bëjë që ata të dyshojnë në aftësitë e tyre dhe të vënë në dyshim pikat e forta. Andaj, punoni me t'a për ndryshimin e planit

nëse gjërat nuk funksionojnë, dhe t'i inkurajoni ata të jenë të gatshëm për të marrë përgjegjësi për zgjedhjet e tyre, edhe atëherë kur sfidat dhe dështimet janë ballë tyre. Nxënësit që përjetojnë vështirësi në të nxënë në këtë fazë tranzicioni, kanë motivim më të ulët dhe më pak besim te vetja, madje, në disa raste, kanë ndjenja shtypjeje dhe dëshpërimi. Ndonjëherë, këto ndjenja janë të shprehura me inat, zemërim dhe duke treguar një karakter kundërshtues. Këta nxënës kanë më shumë gjasa të përfshihen në të mësuar, nëse shohin se përpjekjet e tyre nuk shkojnë kot, por përkundrazi, vlerësohen.

Parimi 4. Bëni përpjekje t'a menaxhoni stresin tuaj dhe t'a arrini qëllimin e synuar.

Mësimdhënësit duhet të fokusohen në qëllimin e tyre gjatë mësimdhënies, dhe të përkushtohen aq sa munden në arritjen e objektivave për këta nxënës, meqenëse në një situatë ku mësimdhënësi u mungon përvoja në mësimin online, ndikon që këto ditë mund të kthehen “në periudha ankthi dhe stresi të jashtëzakonshëm”. Dhe, si rezultat mos menaxhimi në nivelin e duhur i kësaj situatë mund të ndikoj që stresi i tepërt të reflektohet edhe tek nxënësit.

Parimi 5. Specifikoni kërkesat tuaja në mënyrë që mos t'a tejkalojnë nivelin e zhvillimit të nxënësve me nevoja të veçanta.

Mësimdhënësit mund të ndihen konfuzë lidhur me standardet dhe kriteret të cilat duhet të mbështeten për vlerësimin objektiv të nxënësve me nevoja të veçanta gjatë mësimin në distancë/online, por gjithsesi ata duhet të kenë kujdes të shtuar që të mos i mbingarkojnë këta nxënës me detyra, dhe kërkesat e tyre mos t'i tejkalojnë aftësitë e këtyre nxënësve në të nxënë apo aftësitë moshore për përpunimin e informacioneve. Përpiquni që materialet, detyrat, testet etj t'i përshtasni me mundësitë dhe nivelin zhvillimor të fëmijëve me nevoja të veçanta.

2. TEJKALIMI I SFIDAVE NË MËSIMNXËNIE GJATË MËSIMIT NË DISTANCE PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Sipas OJQ Handikos në Drenas, me anë të vizitave të vazhdueshme në terren në familjet e fëmijëve me nevoja të veçanta, dhe nga komunikimi i vazhdueshëm i KKPAK me vet fëmijët, prindërit e tyre dhe mësimdhënësit, shumica prej tyre jetojnë nën kufirin e varfërisë në Drenas, andaj sfidë në vete konsiderohet mungesa e pajisjeve të nevojshme për të mësuar, por ata përveqëse nuk mund të blejnë pajisje u mungojnë edhe instruksionet apo trajnimet e duhura për t'i përdorur ato. Në mungesë të pajisjeve për të mësuar në formën online, mësimdhënësit sigurisht duhet të shohin mundësitë dhe bëjnë përpjekjet e duhura për t'u siguruar pajisjet e mundshme, të cilat shihen si mjete elementare për të realizuar komunikimin në aspektin e të nxënës. Përveq kësaj, dhe pse ka shumë standarde teknike dhe specifika për t'i bërë të mundshme platformat e mësimin elektronik, perspektiva pedagogjike dhe didaktike e aksesit nuk është studiuar sa duhet, sepse nxënësit me nevoja të veçanta mund të hyjnë në platformën e mësimin elektronik por jo lehtësisht edhe në

përmbajtjen, burimet, aktivitetet, bashkëpunimin dhe mjetet e ndërveprimit. Nga ky aspekt, ne shohim se këta nxënës ballafaqohen me lloje të ndryshme të vështirësive që ju sjellin aftësitë e tyre të kufizuara, p.sh. përmbajtja brenda imazheve grafike mund të jetë e pakuptimtë për dikë që është i verbër, apo fjalët e folura në një audio clip janë potencialisht të padisponueshëm për dikë që është i shurdhër.

Bazuar në vështirësitë që hasen këta nxënës gjatë të nxënimit në formën virtuale apo online, mësimdhënësit mund të ua lehtësojnë përballjen me këto vështirësi duke ndjekur disa parime:

Parimi 1. Jepuni kohë shtesë nxënësve me nevoja të veçanta për të kryer një aktivitetet në lidhje me mësimin pasi që ata kanë nevojë për pushime me të shpeshta.

Nxënësve me nevoja të veçanta, shpesh u duhet të punojnë më gjatë në disa mësimet për shkak të paftësisë së tyre, andaj përpikuni t'u jepni më shumë kohë, si dhe të zhvilloni materiale të arritshme dhe të adaptuara, për të mbështetur mësimin në distancë/online. P.sh. “Në vend se të filloni me një nocion të paracaktuar se si nxënësit duhet të mësojnë, mësimdhënësit mund të fillojnë duke hetuar se si nxënësit në të vërtetë mësojnë”.

Parimi 2. Mësimdhënësit duhet të ndjekin trajnime dhe t'i inkurajojnë nxënësit me nevoja të veçanta dhe prindërit e tyre që të informohen për udhëzuesit ekzistues online të ofruar nga profesionistë si mbështetje lidhur me përdorimin e teknologjisë.

Bazuar në këtë parim, nëse mësimdhënësit konsiderojnë se kanë nevojë për informacione shtesë lidhur me përdorimin e aplikacioneve në mënyrë që t'ua mundësojnë më lehtë mësimnxënien nxënësve me nevoja të veçanta, atëherë trajnimet dhe udhëzuesit do të jenë zgjidhja. Palët e involvuara në mësimin online bashkërisht do të vlerësojnë se zgjidhjet më inovative vijnë nga një nevojë e fortë për të kapërcyer një problem si dhe kufizimet aktuale mund të nxisin motivimin për të menduar për zgjidhje krijuese. Nga ky aspekt, rritet interesimi i nxënësve me nevoja të veçanta për mësimin në distancë/ online, por edhe kureshtja dhe dëshira për të fituar njohuri të reja; prindërit, ndihen më të sigurtë që fëmijëve të tyre u ndihmojnë të përgatisin më lehtë detyrat e shkollës dhe të mësojnë përmbajtjet mësimore; mësimdhënësit, shohin se një mori ‘çështjesh teknike’, por duke ndjekur standardet e vendosura ka përmirësuar nivelin e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në procesin mësimor online dhe në aktivitetet shkollore, duke inkurajuar ndjenjën e barazisë dhe rritur nivelin e vetëbesimit.

Parimi 3. Mblidhni të dhëna ndaras për secilin nxënës lidhur me llojin e aftësisë së kufizuar të tyre, në mënyrë që të reagoni urgjentisht, të monitoroni dhe të ndihmoni me ndërhyrjet e përshtatura gjatë mëimit në distancë.

Përpjekjet për ta bërë mësimin online në dispozicion të të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta në mënyrën e zbatimit janë të domosdoshme, që nxënësit të bashkëveprojnë me kompjuterin. Andaj, bazuar në pengesat që hasen nxënësit gjatë mëimit në distancë apo online, kërkojnë pajisje të specializuara, zakonisht të referuara si "teknologji ndihmëse" për të ju përshtatur nevojave të tyre p.sh. opzione aksesit në tastierë (tastiera me butona të mëdhenj), në miun, madhësia e fontit, përshtatja e ngjyrave, sigurimi i përmbajtjes ekuivalente vizuale dhe dëgjimore etj. Megjithatë,

shkalla në të cilën shërbimet do të ofrohen ndryshe për nxënësit me nevoja të veçanta, varen nga institucionet përkatëse, dhe jo drejtpërdrejtë nga vetëm mësimdhënësit, sepse ky shërbim ka koston e ndërmarrjes së një hapi të veçantë.

Parimi 4. Vlerësoni nëse nxënësit tuaj kanë qasje të besueshme në teknologji përpara se të filloni mësimin me ta.

Jo çdo shtëpi do të ketë gjithnjë një lidhje të besueshme në internet ose pajisje të gatshme që nxënësit të përdorin. Një email, një mesazh ose një tekst fillestar nga mësimdhënësit për prindërit do t'u japë atyre mundësinë për të shënuar këto çështje në mënyrë që të përgaditeni për të akomoduar nxënësit përpara kohe. Kjo pasi që problemet me internetin apo pajisjet tjera, mund të ndikojnë tek nxënësit që të dorëzohen nga mësimi, dhe “dështimet” e tilla apo mospërbushjen e përpjekjeve të tyre mund të ua atribuojnë vetes.

Parimi 5. Gjeni më shumë këshilla për komunikim me nxënësit me nevoja të veçanta gjatë mësimin online apo në distancë.

Nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevojë për më shumë vëmendje nga mësimdhënësit, sepse si të tillë janë në rrezik të shpëputjes nga mësimi. Mos lejoni që të bëheni një robot i cili komunikon vetëm përmes tekstit me nxënësit. Gjatë komunikimit, tregoni fytyrën tuaj dhe lëroni nxënësit të dëgjojnë zërin tuaj, duke përdorur video ose regjistrime audio. Përmes kësaj forme do të hapen mundësitë që komunikimin me nxënësit t'a shoqëroni me ndonjë kompliment, lëvdatë dhe rritje të motivimit.

3. BASHKËPUNIMI MËSIMDHËNËS – PRIND, GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Bashkëpunimi mësimdhënës - prind është më e vështirë për tu promovuar dhe mbajtur në qoftë se mësimdhënësit dhe prindërit punojnë si njësi të veçanta. Mësimdhënësit dhe prindërit duhet të njohin interesat dhe përgjegjësitë e tyre të përbashkëta për nxënësin, dhe të punojnë në bashkëpunim për të krijuar mundësi më të mira për nxënësin. Mësimdhënësit dhe prindërit kërkojnë komunikim aktiv me njëri-tjetrin për vendimmarrje dhe ide të përbashkëta, për të planifikuar programin individual të arsimit PIA dhe për të diskutuar mënyrat e përmirësimit të performancës së nxënësit me nevoja të veçanta. Prandaj, komunikimi midis mësimdhënësve dhe prindërve duhet të jetë në një larmi formash dhe nuk duhet të jetë vetëm një-dimensionale. Hulumtimet tregojnë se mësimdhënësit dhe prindërit duhet të bashkëpunojnë për t'u përshtatur në mënyrë më efektive dhe të përgjegjshme rolet dhe veprimet e tyre për të përmirësuar vazhdimisht rezultatet e zhvillimit të nxënësve.

Për të mbështetur njëri-tjetrin në mësimin online, mësimdhënësit dhe prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta duhet të lundrojnë së bashku drejt qëllimit të përbashkët, duke ndjekur disa parime:

Parimi 1. Inkurajoni prindërit për të kryer rolet e tyre në mënyrë efektive në zhvillimin dhe performancën akademike të fëmijës së tyre me nevoja të veçanta.

Ky partneritet mes mësimdhënësve dhe prindërve ndihmon nxënësit të përfitojnë në aspektin menaxhimit të kohës dhe planifikimit të mësimi, vendosjen në hapësira specifike që fëmija të angazhohet në punë shkollore por mbi të gjitha kërkon shumë durim, planifikim dhe strukturë në zbatim. Por, në asnjë mënyrë prindërit të ua kryejnë detyrat fëmijëve të tyre.

Parimi 2. Përpikuni që prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta t'u ofroni informata të mjaftueshme dhe të qarta për t'i ndihmuar fëmijët e tyre gjatë mësimi online.

Mësimdhënësit duhet të bëjnë përpjekje në mënyrë që prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta të u sigurojnë udhëzime dhe burime të rëndësishme, të bazuara në prova se si t'i ndihmojnë fëmijët gjatë mësimi online për të lehtësuar arsimimin e tyre efektiv. Nga ky aspekt, prindërit varësisht nga niveli i njohurive dhe edukimit të tyre, mund të u ofrojnë ndihmën e nevojshme fëmijëve të tyre apo të zgjedhin të kërkojnë ndihmë tek një i afërm duke i dhënë fëmijës mbështetje individuale në mënyrë që të maksimizohen mundësitë për të qenë më aktiv në mësim.

Parimi 3. Rishikoni qëllimet e PIA (Plani Individual i Arsimit) për nxënësit me nevoja të veçanta.

Mësimdhënësit, për secilin rezultat mësimor të planifikuar për ta arritur gjatë mësimi në distancë, duhet të ofrojnë udhëzime, detyra dhe materiale konkrete për prindër. Puna dhe aktiviteti i nxënësit duhet të dëshmohet nga prindi, ndërsa edukatorja, mësimdhënësi i klasës apo mësimdhënësi lëndor duhet të krijojë portfolion elektronike të secilit nxënësi. Rezultatet e synuara ndahen në hapa të vegjël dhe të thjeshtë që puna e nxënësit të jetë konkrete dhe e matshme. Për secilin hap të punës që synon arritjen e rezultatit individual duhet të jenë të paktën dy dëshmi të punës së nxënësit p.sh: foto, video, etj. Mësimdhënësit gjithashtu duhet të mbajnë listën e kontrollit të detyrave që siguron mbarëvajtjen e përfundimit të aktiviteteve/detyrave të nxënësit në kohën e caktuar. Shumë nxënës me nevoja të veçanta u duhet të kenë mbështetje lidhur me shërbimin (p.sh. terapia e të folurit ose e gjuhës, këshillimi ose terapia profesionale), të cilat janë thelbësore për suksesin e tyre arsimor. Andaj, është e domosdoshme që mësimdhënësit të rishikojnë PIA të secilit nxënësi për të përcaktuar me kë do të duhet të bashkëpunojnë (p.sh., punonjësit socialë, psikologët e shkollës ose terapistët e të folurit) për të përmbushur më së miri qëllimet e PIA së nxënësve të tyre.

Parimi 4. Mbron nxënësit/fëmijët në internet.

Platformat dixhitale ofrojnë një mundësi për fëmijët që të vazhdojnë të mësojnë, të marrin pjesë në lojë dhe të mbajnë kontakte me shokët e tyre. Por rritja e aksesit në internet sjell rreziqe të mëdha për sigurinë, mbrojtjen dhe intimitetin e fëmijëve. Në raste të tilla, nxënësit me nevoja të veçanta kanë gjasa të ofendohen dhe ngacmohen në formën virtuale, që mund të ndikojnë negativisht në jetën e tyre. Inkurajoni prindërit që të vendosin kontrolle prindërore në pajisjet e tyre për të zbutur rreziqet në internet, veçanërisht për fëmijët e tyre me nevoja të veçanta. Inkurajoni prindërit që të diskutojnë me fëmijët e tyre në mënyrë që ata të dinë se si funksionon,

për çfarë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe si duket sjellja e përshtatshme në platformat që përdorin, siç janë audio, video thirrjet.

Parimi 5. Bashkërisht me prindërit përqendroni vëmendjen tuaj në mirëqenien emocionale të nxënësve me nevoja të veçanta.

Ndikimi i kësaj krize për nxënësit me nevoja të veçanta është më i madh dhe ka ndryshuar trajektoret e tyre të të mësuarit dhe të zhvillimit, prandaj mësimdhënësit së bashku me prindërit e nxënësve duhet të gjejnë mënyra të përbashkëta për të ofruar mbështetje. Mësimdhënësit në bashkëpunim me prindërit, duhet të identifikojnë se çfarë kanë nevojë nxënësit, në mënyrë që të jenë të suksesshëm, të respektojnë ato nevoja dhe të ofrojnë mbështetje të harmonizuara me nevojat e tyre. Është më mirë që mësimdhënësit të mos supozojnë se e dinë çfarë do t'ju nevojiten nxënësve - askush nuk ka qenë më parë në këtë situatë krize. Mësimdhënësit duhet të shmangin kërkesat e tyre ndaj nxënësve me nevoja të veçanta që të përfshihen në detyra për të cilat ata nuk kanë mbështetjen që mund të kenë në klasë, në mënyrë që t'u shmangen situatave të sikletshme. Mundohuni të mos minimizoni ose shmangni shqetësimet e tyre. Ky partneritet, përceptohet si investim në marrëdhënien me nxënësit/fëmijët.

4. BASHKËPUNIMI MËSIMDHËNËS – PSIKOLOG GJATË MËSIMIT NË DISTANCË NË LIDHJE ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Është e rëndësishme që nxënësit me nevoja të veçanta përveq mësimnxënies online, të mësojnë se si të funksionojnë në mënyrë shoqërore, emocionale dhe të sjelljes, gjatë kësaj periudhe. Nganjëherë psikologët bëhen ‘avokatë’ të fortë për nxënësit, dhe ata zakonisht i referojnë nxënësit dhe i mbështesin me burime që mbështesin rritjen e tyre. Për shembull, disa nxënës me nevoja të veçanta mund të përfitojnë nga ndërhyrjet specifike, të tilla si terapia profesionale, terapia e të folurit, këshillimi, terapia e artit ose terapi fizike, por këto ndërhyrje realizohen vetëm nëse mësimdhënësi me psikologun bashkëpunojnë ngushtësisht.

Për të krijuar një mjedis të sigurtë të mësimin online për nxënësit me nevoja të veçanta dhe për të minimizuar boshllëqet e krijuara nga lloji i aftësisë së kufizuar të nxënësit, ndiqni këto parime:

Parimi 1. Mbani kontakte të vazhdueshme me psikologun për të azhurnuar në përparimin e nxënësve.

Psikologu mundëson mbështetje të vazhdueshme përmes ofrimit të shërbimit psikologjik në familje si për fëmijët, por edhe për prindërit. Psikologu komunikon rregullisht me nxënësit dhe/ose prindërit e tyre në kohën e duhur për të siguruar që ata kanë sukses apo progres me mësimin në distancë. Përveq kësaj, psikologu monitoron vazhdimisht nevojat e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve për t'i ndihmur të zgjidhin problemet e tyre, sipas nevojës.

Parimi 2. Kërkoni ndihmë nga psikologu (psikologu i shkollës apo ai komunal) nëse ndiheni konfuzë në raste të caktuara gjatë punës me nxënësit me nevoja të veçanta.

Jo të gjitha pengesat janë akademike. Mund të jenë çështje sociale, probleme emocionale, çështje familjare, etj. Dhe kështu, psikologu është me të vërtetë në gjendje të punojë me nxënësit për t'i ndihmuar ata të kapërcejnë disa prej këtyre pengesave, në mënyrë që ata të mund të përfitojnë nga arsimi që u ofrohet atyre. Psikologu mbase mund të u ndihmojë të kuptoni se si një nxënës përpunon informacionin pak më ndryshe nga të tjerët, në mënyrë që mësimit të formulojë teknika që do ta mbështesin atë nxënës në mësimin online apo në distancë.

Parimi 3. Diskutoni me psikologun për të ndarë grupe me të vogla të nxënësve gjatë mësimit online, në mënyrë që të keni interaktivitet nxënës-nxënës dhe nxënës-mësimit.

Mësimdhënia në distancë/ online me grupe të mëdha të nxënësve me 30-40 nxënës, nuk është produktive, dhe nuk mund të sigurojë cilësinë e një ore mësimore sikurse në ambientet shkollore, në veçanti me nxënësit me nevoja të veçanta. Andaj, përpikuni që të krijoni grupe më të vogla me nxënës, në mënyrë që të realizohen dialogjet me mirkufon të hapur dhe të kenë mundësinë për inkadrim të gjithë nxënësit. Grupet e krijuara me nxënës mund të nryshohen çdo javë, ku nxënësit do t'a kenë mundësinë e bashkëveprimit dhe interaktivitetit me të gjithë.

Parimi 4. Kontaktoni me psikologët dhe profesionistë të tjerë për të marrë këshilla, shërbime dhe materiale atëherë kur aftësia e kufizuar e nxënësve ua pamundëson marrjen pjesë në mësimin online së bashku me klasën.

Nxënësit me nevoja të veçanta shpesh herë u duhet përkrahje individuale, andaj mësimit duhet të jenë të vëmendshëm që në rast të mungesës së informacionit për mënyrën e qasjes dhe hapat e duhur, perkitazi me problemin apo nevojën e nxënësit, të lidhin bashkëpunim me profesionistë adekuat për të ju ndihmuar në zgjidhjen e saktë dhe të shpejtë të alternativave. Gjithashtu, duhet t'a keni parasysh që për një mbarëvajtje të suksesshme të mësimit online, duhet t'a mbani një orar të caktuar të mbajtjes së orës mësimore dhe jo të ndryshohen ato çdo ditë, sepse mund të krijojë konfuzion tek nxënësit.

Parimi 5. Bashkëpunoni me psikologun për të shqyrtuar vlerësimin lidhur me të nxënësit e nxënësve me nevoja të veçanta bazuar në Planin Edukativ Individual (PEI).

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbushje të rezultateve të të nxënësit. Mësuesi ndihmës në bashkëpunim me mësuesin e klasës/lëndës, prindin dhe psikologun e shkollës, vlerëson ecurinë e nxënësit me nevoja të veçanta, bazuar në Planin Edukativ Individual (PEI). Gjatë vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta mund të bëhen edhe modifikime që përfshijnë: ■ përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh., një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit; ■ modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh., duke thjeshtuar gjuhën e përdorur ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi; ■ përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh., duke i dhënë kohë shtesë

nxënësit. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënësit me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit, psikologun e shkollës dhe vetë nxënësit.

5. BASHKËPUNIMI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ME BASHKËMOSHATARËT E TYRE - INKURAJIMI NGA MËSIMDHËNËSIT

Mësimi nga shtëpia mund t'i bëjë nxënësit me nevoja të veçanta të ndihen të vetmuar. Pa lëvizjen nëpër klasë dhe shoqërinë e bashkëmoshatarëve të tyre, nuk është për t'u habitur që disa nxënës mund të fillojnë të ndiejnë një ndjenjë të fortë izolimi që zvogëlon ngadalë dëshirën e tyre për të mësuar veçanërisht nëse kanë qenë në një mjedis gjithëpërfshirës në shkollë. Andaj, lidhjet me bashkëmoshatarët janë thelbësore për nxënësit. Ndërtimi dhe ruajtja e miqësive nuk është gjithmonë e lehtë për nxënësit me nevoja të veçanta. Shumë prej nxënësve që u mungojnë miqësitë në lagjet e tyre përballen me izolimin shoqëror, andaj mbështeten tek shokët/shoqet me të cilët lidhen në shkollë, kjo madje u ndihmon për të lehtësuar edukimin e tyre efektiv dhe maksimizuar zhvillimin akademik dhe shoqëror.

Andaj, meqë bashkëmoshatarët shihen si një faktor me ndikim në të nxënit dhe aspekte të tjera tek nxënësit me nevoja të veçanta, ky efekt duhet të merret në konsideratë, duke shqyrtuar disa parime:

Parimi 1. Inkurajoni nxënësit me nevoja të veçanta të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarët e tyre gjatë mësimin në distancë apo online.

Mësimi bashkëpunues mund të ndihmojë nxënësit me nevoja të veçanta, të trembur për të marrur fjalën dhe të shprehen më shumë. Nxënësve me nevoja të veçanta, ndjekja e arsimit në distancë, mund të u ofrojë rritjen e mundësive, për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe bashkëveprimit me moshatarët e tyre. Andaj, me anë të inkurajimit për përfshirje shoqërore, mund të reduktohen në një masë etiketimet negative, por edhe të ketë rritje të cilësisë në mësimnxënie.

Parimi 2. Mblidhni rezultatet nga puna e bashkëpunimit mes nxënësve dhe pasi të keni vlerësuar përdorni ato për të dhënë gjykimet tuaja mbi përparimin e tyre.

Lërimi nxënësit me nevoja të veçanta të punojnë me një shok/shoqe të besueshëm për tu siguruar që vlerësimi të jetë kuptimplotë dhe i vëmendshëm. Nga ky aspekt, nëse bashkëpunimi rezulton i suksesshëm, vlerësoni nxënësit me pikë maksimale, dhe kjo do të ndikojë për të ngritur besimin e tyre. Ky proces ndihmon të gjithë fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten. Pra, varësisht nga rezultati, mund të jetë një ide e mirë për të modeluar procesin.

Parimi 3. Planifikoni të kontribuoni në uljen e ankthit tek nxënësit me nevoja të veçanta duke i inkurajuar që t'i ndajnë idetë e tyre me bashkëmoshatarët gjatë mësimin online

Nxënësit me nevoja të veçanta kanë nevojë t'u vlerësohen përpjekjet e tyre për t'a përmirësuar rezultatin e grupit ku marrin pjesë gjatë nxënies, apo çfarëdo aktiviteti tjetër. Në lidhje me këtë,

merrni hapat e duhur dhe në kohën e duhur (menjëherë), në mënyrë që t’u dijnë përse po vlerësohen dhe duartrokiten. Kjo përvojë mund t’i ndihmojë ata që të ndajnë ndjenjat e tyre dhe ulin nivelin e ankthit. Në të kundërtën nëse këta nxënës nuk gjejnë një grup bashkëmoshatarësh që ndihen të sigurtë për bashkëpunim, rriten gjasat e konfrontimit kur është i mërziur, zemëruar etj.

Parimi 4. Zhvilloni herë pas here biseda në grup/ role-play online mes nxënësve me nevoja të veçanta dhe bashkëmoshatarëve të tyre me qëllim ndarjen e mendimeve dhe koncepteve mbi tematika të ndryshme, përmirësimin e aftësive të komunikimit, identifikimin e problematikave/elementëve të abuzimit përmes komunikimeve online si edhe mbështetjen në menaxhimin e situatave emocionale/strestante.

Kur nxënësit bëjnë atë çka ata duan, procesi të mësuarit bëhet më kuptimplotë, dhe ata i mbajnë mend më mirë informacionet, në të kundërtën, mësimi mund të mos ketë kuptim. Meqenëse, shpesh herë nxënësit me nevoja të veçanta vihen në shënjestër për t’u ngacmuar apo përjashtuar nga grupet shoqërore edhe në formën online, realizoni luajtjen e roleve online përmes skeqeve. Në këtë aspekt, tek nxënësit do të nxiten ndjenjat dhe do të diskutohet hapur për mënyrën se si ndihen ata në situatat kur janë në rolin e nxënësit ngacmues, viktimës, apo edhe vëzhguesit pasiv të asaj situate. Nga ky aspekt, mund të kontribuoni që nxënësit të ndërgjegjësohen për sjelljet e pa tolerueshme dhe gjithashtu të përmirësohen.

Parimi 5. Sigurohuni që nxënësit me nevoja të veçanta mos të kopjojnë detyrat nga bashkëmoshatarët e tyre, gjatë mësimit online.

Për shembull, kur grupe nxënësish punojnë së bashku për një projekt, dallimi midis bashkëpunimit të ndershëm dhe ndonjë marrëveshjeje të pandershme midis tyre mund të mos jetë kaq i qartë. Disa nxënës duke menduar se po e ndihmojnë në detyra me bashkëpunim një nxënës me nevoja të veçanta, mund të ua dërgojnë detyrat e zgjidhura... në raste të tilla, mund të ndodhë që disa prind me pritshmëri të ulëta për fëmijën e tyre, përmbushën ngase kanë gjetur detyrat e gatshme tek një shok/shoqe e fëmijës së tyre. Në raste të tilla, pëson më së keqi nxënësi me nevoja të veçanta. Andaj, ju si mësime dhënë duhet të gjeni një rrugë dalje, dhe t’ua bëni me dije prindërve të atyre fëmijëve se nota nuk është gjithçka. Reduktoni kërkesat tuaja për këta nxënës nëse e shihni të nevojshme dhe krijoni pritje perkitazi me ato kërkesa.

6. SHPESHTËSIA E KOMUNIKIMIT TË MËSIMDHËNËSVE ME NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA GJATË MËSIMIT NË DISTANCË/ ONLINE

Komunikimi mësime dhënë-nxënës edhe gjatë mësimit online përdorë ndërthurjen e teknologjive të ndryshme, duke bërë të mundur që mësime dhënësit dhe nxënësit të shohin dhe të dëgjojnë njëri-tjetrin, duke qenë të vendosur në vende të ndryshme. Nga ky aspekt, ndërveprimi mes tyre mund të realizohet suksesshëm, dhe të jetë i pavarur nga largësia dhe koha. Komunikimi i duhur dhe

efektiv i ndihmon edhe vetë mësime të mësimdhënës në arritjet e suksesit të tyre, sa më lartë të ngjiten në shkallët e hierarkisë organizative, aq më i rëndësishëm bëhet komunikimi.

Për t'a lehtësuar komunikimin mësime të mësimdhënës-nxënës, gjatë mësimit online apo në distancë është e rekomandueshme që të praktikohen disa parime:

Parimi 1. Vendosni lidhje pozitive me nxënësit me nevoja të veçanta dhe familjet e tyre që nga fillimi.

Mësuesit e mirë zhvillojnë marrëdhënie produktive me nxënësit e tyre me nevoja të veçanta; ata i njohin dhe marrin në interes të veçantë zhvillimin dhe përparimin e tyre. Ata i trajtojnë nxënësit me respekt dhe presin të njëjtën gjë në rikthim. Nxënësit me nevoja të veçanta sikur kanë një “zë” që duhet të konsultohen sa më shpesh që të jetë e mundur.

Parimi 2. Strategjitë që zhvillonin gjatë mësime të mësimdhënës me nxënësit me nevoja të veçanta gjatë mësimit online, duhet të jenë të shkallëzueshme dhe fleksibël dhe jo të ‘përhershme’, në mënyrë që ata të mund të evoluojnë.

Të jesh mësime të mësimdhënës efektiv përveç komunikimit të vazhdueshëm me nxënësit kërkon shumë strategji, shumica prej të cilave zgjidhen përmes provës dhe gabimit. Shumë burime janë në dispozicion për të ndihmuar mësuesit që planifikojnë mësime, menaxhojnë mësime në mjediset jo të zakonshme dhe zhvillojnë udhëzime me cilësi të lartë për nxënës me nevoja të veçanta. Andaj, mësime të mësimdhënës duhet të hartojnë plane mësimore që mund të modifikohen për t'iu përshtatur secilit si dhe shtojnë kreativitet në mësime dhe detyrat e shtëpisë.

Parimi 3. Identifikoni vështirësitë e ndryshme që minojnë mundësinë e marrjes pjesë aktive në mësime për nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit mund të kenë mungesë të pajisjeve kyçe për t'a ndjekur mësimin dhe realizuar mësime të mësimdhënës, si rezultat i vështirësive ekonomike. Bisedoni lirshëm me nxënësit për këto sfida, dhe pastaj problemin provoni t'a adresoni tek drejtori i shkollës apo personat përgjegjës për t'u mundësuar sigurimin e këtyre mjeteve përmes donatorëve apo në forma të tjera.

Parimi 4. Nëse shkollat kanë mungesë të psikologëve, inkurajoni bashkëpunimin në mes të punonjësve social dhe nxënësve me nevoja të veçanta, për të diskutuar shëndetin mendor përmes klasave virtuale

Mbyllja e shkollave ka prekur edhe ofrimin e shërbimeve thelbësore, sociale që lidhen me nxënësit me nevoja të veçanta. Ndryshimet rrënjësore të rutinës, janë shumë herë më serioze për fëmijët e marginalizuar, siç janë fëmijët me nevoja të veçanta sesa për bashkëmoshatarët e tyre. Ata vihen para shumë rreziqeve ndër të cilat janë, dhuna në familje, shfrytëzimi seksual, braktisja e shkollës etj. Andaj, rekomandohet që mësime të mësimdhënës të inkurajojnë këtë bashkëpunim për të përmbushur nevojat psikosociale dhe ato të shëndetit mendor të nxënësve me nevoja të veçanta.

Parimi 5. Kërkoni fidbek (feedback) nga nxënësit dhe anasjelltas, në mënyrë që të shihni nëse idetë dhe ndjenjat që po ndani mes jush, janë duke u bërë në mënyrë të kuptueshme ose jo.

Futja e teknologjive të reja ka sjellur ndryshime edhe në raportin e komunikimit mësimdhënës – nxënës. Përparësia e fidbekut është që të dy, dëgjuesi dhe folësi bëhen më të sigurt që mesazhi është komunikuar saktësisht. Nga ky aspekt, dhënja dhe marrja e fidbekut nuk është vetëm një opsion por edhe një nevojë për ta bërë procesin mësimor më atraktiv dhe kuptimplotë për të gjithë nxënësit, e në veçanti për nxënësit me nevoja të veçanta, pasi që vëmendja dhe kujtesa e tyre përmirësohen, kur detyra është interesante, kur atij i kërkohet të jetë aktiv dhe kur kjo detyrë merr feedback pozitiv dhe korrigjues nga mësuesi.

LITERATURA

- Instituti Pedagogjik i Kosovës (2011). Kërkime Pedagogjike (Përmbledhje Punimesh). Marrë nga: <http://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/11/K%C3%ABrkime-Pedagogjike-2.pdf>
- Hyseni-Duraku, Z. & Hoxha, L. (2020). Ndikimet e Covid-19 në arsim, mirëqenien e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve. *Sfidat e ndërlidhura me mësimin në distancë (online) dhe mundësitë për avancimin e cilësisë së arsimit*, Prishtinë, pp. 4-6. Marrë nga: https://www.researchgate.net/publication/342109343_Ndikimet_e_COVID-19_pervoja_traumatike_dhe_sjelljet_e_femijeve_ne_stresin_prinderor_praktikat_e_prind_erimit_dhe_ndryshimet_ne_sjelljen_e_femijeve
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2006. Marrë nga: http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf
- Ligji i Individëve me Aftësi të Kufizuara të Amerikës, 2005. Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/doracaku-per-identifikimin-arsimimin-femijeve-me-nevoja-te-vecanta-2.pdf>
- MASHT (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
- WORLD VISION (2012). E DREJTA E FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR ARSIM GJITHËPËRFSHIRËS. Marrë nga: https://www.wvi.org/sites/default/files/Raport_Rajonal_2_Alb_Web.pdf